



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 28 mars dhe 3 prill 2014, pas shqyrtimit të projekt-deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile, me propozimin e deputetit Glauk Konjufca dhe grupit të deputetëve nënshkrues, nxori këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi angazhohet të rrisë pjesëmarrjen e publikut në hartimin, shqyrtimin dhe zbatimin e legjislacionit në Kuvendin e Kosovës,
2. Kuvendi zotohet të avancojë bashkëpunimin ndërmjet institucionit tonë dhe Shoqërisë Civile nëpërmjet bashkëpunimit të rregullt, rritjes së shkëmbimit të informatave dhe zhvillimit të aktiviteteve në projekte të përbashkëta,
3. Kuvendi e mbështet vullnetarizmin dhe aktivizimin qytetar për promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë,
4. Kuvendi angazhohet ta zhvillojë një kornizë të favorshme ligjore dhe financiare, e nevojshme për zhvillimin dhe forcimin e Shoqërisë Civile në Kosovë,
5. T'i zhvillojë dhe zbatojë procedurat e nevojshme që garantojnë konsultim të publikut, përfshirë Shoqërinë Civile në punët e Kuvendit,
6. Inicimin dhe shqyrtimin e legjislacionit, si dhe proceset e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij legjislacioni,
7. Të krijojë projekte dhe aktivitete të përbashkëta me Shoqërinë Civile për të promovuar pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Kosovës, pra në formë të fushatave, të vetëdijesimit dhe të përfshirjes,
8. Të bashkëpunojë ngushtë me Shoqërinë Civile për zgjidhjen e çështjeve lidhur me rregullimin e financimit të aktivitetit të Shoqërisë Civile për ta mbështetur zhvillimin e një sektori të fuqishëm dhe të pavarur të Shoqërisë Civile në Kosovë,

9. Të organizojë të paktën një herë në vit një konferencë së bashku me Shoqërinë Civile, me qëllim të diskutimit të çështjeve strategjike të rëndësishme për zhvillimin e vendit, si dhe për të adresuar çështje të rëndësishme, të cilat lidhen me funksionimin e sektorit të Shoqërisë Civile, si dhe

10. Të themelohet një grup Kuvend - Shoqëri Civile, i përbërë nga deputetë dhe stafi i Kuvendit, si dhe përfaqësues të ndryshëm të Shoqërisë Civile për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj deklaratë.

Nr. 04-DO-2165/1

Prishtinë, më 3 prill 2014

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Deklarata i dërgohet:

- Deputetit Glauk Konjufca,
- Arkivit të Kuvendit.